



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:296478

Datë: 15.01.2021

Numri i dokumentit: 01413930

C.nr.1174/19

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni civil, përmes gjyqtarit Blerim Beshtica, me zyrtaren ligjore Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G. T. nga Gjilani, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson Fatos Zeqiri, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës U.K. Z..., me seli në Gjilan, të cilën e përfaqëson zyrtari ligjor K. D, me objekt kontesti mos avancim të paligjshëm (diskriminim) dhe kompensim i të ardhurave personale, pas mbajtjes së seancës per shqyrtimin kryesor e publik me datën 03.12.2020, me datë 15.01.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit G. T nga Gjilani, e paraqitur kundër të paditurës U.K.Z..., me seli ne Gjilan, me të cilën ka kërkuar që e paditura t’ia lidhë kontratën e punës në pozitën Profesor i Asociuar nga data 01.10.2019 e deri me datë 31.09.2023, sipas konkursit me numër të referencës ... të datës 14.06.2019 si dhe në bazë të rekomandimit të Komisionit Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik të datës 04.09.2019.

II. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që e paditura, në emër të të ardhurave personale të përealizuara në lidhje me diferencën e pagës nga data 01.10.2019 e deri me datën 10.11.2020, t’i paguaj shumën prej 2194,17 €, duke i përfshirë të hyrat në emër të trustit personal dhe tatimit në pagë, e deri në pagesën definitive apo deri në momentin e lidhjes së kontratës me kamatëvonesë ligjore prej 8 %, e të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:

Paditësi G. T, nga Gjilani, , të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson F. Z, avokat nga Prishtina, , më datë 24.12.2019, ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës U. “K. Z”..., me seli në Gjilan, të cilën e përfaqëson zyrtari ligjor K. D, për shkak të mos avancimit të paligjshëm (diskriminim) dhe kompensim të të ardhurave personale. Paditësi në padinë dhe kërkesëpadinë e tij, deklaron dhe thënie në seancat gjyqësore, si dhe fjalën përfundimtare ka theksuar se i njëjti që nga data 01.10.2014 është në marrëdhënie pune në thirrjen akademike Profesor Asistent tek e paditura. I njëjti po ashtu thekson se e paditura me datë 14.06.2019 ka shpallur Konkursin me ref.nr...., të dt.14.06.2019, për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të U. “K. Z”... Gjilani, për vitin akademik 2019/2020 dhe se paditësi kishte aplikuar për thirrjen akademike Profesor i Asociuar në F. E. ...tek e paditura. Më datë 04.09.2019, K. V. për Z. e P. A. ka rekomanduar paditësin për

avancim/zgjedhje për thirrjen akademike Profesor i Acoiuar në F. E. të U. “K. Z.”.... Më datë 29.10.2019, e paditura ka nxjerrë Vendimin nr..., me të cilin ka zgjedhur/rizgjedhur paditësin në thirrjen akademike Profesor Asistent dhe nuk është zgjedhur në thirrjen akademike Profesori i Asociuar, siç ishte rekomanduar nga Komisioni Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit dhe ndër të tjera ky vendim nuk përmban arsyetim se përse paditësi edhe përkundër që është rekomanduar për pozitën Profesor i Asociuar, i njëjti nuk është përzgjedhur. Paditësi, pretendon se me këtë vendim janë shkelur të drejtat e tij, ngase e paditura është dashur të jap arsyetim se përse nuk e ka zgjedhur të njëjtin në thirrjen akademike të rekomanduar dhe se i njëjti vendim është në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (neni 2, par 1.1) ngase paditësit i është mohuar e drejta e avancimit, pa i dhënë asnjë arsye ligjore, prandaj e paditura me mosveprim ka diskriminuar paditësin duke mos trajtuar fare rekomandimin për avancim. Më datë 12.11.2019 i pakënaqur me vendimin e sipër perm., paditësi ka ushtruar ankesë në Komisionin për Ankesa dhe Parashtresa të Senatit në U. “K. Z.” ...dhe përmes kësaj ankese, i njëjti ka kërkuar që të ndryshohet vendimi i nxjerrë dhe të zgjedhet Profesor i Asociuar. Paditësi, po ashtu shton se e paditura ka vepruar në kundërshtim me Statutin e U. “K. Z.” ... (neni 153, par.1 dhe 2), pasi Senati nuk ka kthyer në rishqyrtim propozimin e refuzuar nga komisioni për vlerësim, drejtuar Këshillit të Njesisë Akademike. Tutje paditësi ka shtuar se e paditura edhe përkundër obligimit ligjor (Ligji i Punës, neni 78, par.2), për të vendosur lidhur me ankesën e paditësit, nuk ka adresuar këtë çështje dhe prandaj, në pamundësi për të i realizuar të drejtat e tij përmes procedurave të brendshme tek e paditura, paditësi ka paraqitur padi në këtë gjykatë duke kërkuar nga kjo gjykatë që të aprovojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e tij sipas precizimit të kërkesëpadi së bërë gjatë seancave përgatitore të datës 04.11.2020 dhe 03.12.2020 si të bazuar dhe gjithashtu të obligojë të paditurën që paditësit të i lidhë kontratë në bazë të konkursit dhe rekomandimit të komisionit vlerësues, pra në thirrjen akademike Profesor i Asociuar nga data 01.10.2019 e deri më datën 31.09.2023 (për periudhën 4 vjeçare dhe të realizojë diferencën e të ardhurave personale si pasojë e mos-lidhjes së kontratës së punës në bazë të konkursit për periudhën kohore prej 01.10.2019 e deri më datën 10.11.2020, në shumën totale prej 2194.17 euro, duke përfshirë të hyrat në emër të trustit pensional dhe tatimit në pagë deri në pagesën definitive apo deri në momentin e lidhjes së kontratës me kamatëvonesë ligjore 8%. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës, edhe atë: në emër të shpenzimeve procedurale për përplimin e padisë shumën prej 180 euro, në emër të shpenzimeve të procedurës për përfaqësimin e paditësit në seancat e datës 04.11.2020 dhe 03.12.2020 shumën totale prej 270 euro (për secilën seancë nga 135 euro), në emër të përpilimit të fjalës përfundimtare shumën prej 108 euro, në emër të ekspertizës shumën prej 100 euro, si dhe në emër të taksës për padi shumën prej 30 euro, të gjitha këto në shumën totale prej 616,00 euro.

E paditura, U. “K. Z.” ...Gjilan, më datë 07.02.2020 ka ushtruar përgjigje në padi për pretendimet e palës paditëse duke e kontestuar bazën juridike dhe faktike të padisë dhe duke e konsideruar kërkesëpadinë si të pabazuar në ligj dhe të parakohshme. E njëjta po ashtu, si në përgjigje në padi, edhe në thëniet dhe deklaratimet në seancat gjyqësore, si edhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet për të u zgjedhur në thirrjen akademike Profesor i Asociuar, prandaj organi më i lartë vendimmarrës i U. “K. Z.” ..., ka votuar rigjedhjen në thirrjen akademike Profesor Asistent, e po ashtu, pas ankesës së paraqitur nga paditësi, Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa i Senatit të U. “K. Z.” ..., nuk i ka kthyer përgjigje, pasi që Senati ka vendosur të bëjë rishikimin e dosjeve të kandidatëve të paraqitur në konkurs, si dhe njëkohësisht Komisioni Statutar ka bërë interpretim të ri të neneve ... dhe ... të Statutit të Përkohshëm të U. “K. Z.” ...që prek përmbajtjen e zgjedhjeve/rizgjedhjeve për stafin akademik, ndërsa në bazë të gjetjeve të reja, Senati do të dalë me vendim përfundimtar, ku pas këtij vendimi, palët e pakënaqura mund të atakojnë atë në proces gjyqësor. Tutje e paditura ka

shtuar se konkursi për staf akademik ka një përparësi në raport me konkurset me staf civil, duke theksuar se edhe pse paditësi nuk i ka plotësuar kushtet për avancim, atij nuk iu ka shkëputur marrëdhënia e punës, por se të njëjtin e ka lënë në thirrjen akademike të deritanishme dhe në rast se në konkurs do të aplikonte ndonjë kandidat nga jashtë që do të i plotësonte kriteret e kërkuara, paditësi nuk do të kishte fare marrëdhënie pune me të paditurën. E njëjta, po ashtu deklaroi se Senati i U. “K. Z.” ..., në Gjiilan është trup kolegjal që përbëhet nga: Rektori, prorektorët, dekanët dhe nga një përfaqësues nga stafi akademik i secilës njësi akademike, një përfaqësues nga administrata, dy përfaqësues të studentëve dhe sekretari i përgjithshëm (pa të drejtë vote, ndërsa të tjerët me të drejtë vote) dhe rrjedhimisht vendimi është kolegjal, ndërsa rektori vetëm nënshkruan si kryesues i Senatit. E njëjta, po ashtu, shton se raportin të cilin e ka përpiluar Komisioni Recenzues nuk e ka miratuar fare Këshilli i Fakultetit Ekonomik dhe këtë të drejtë ia ka deleguar Komisionit të Studimeve apo Senatit, çka nënkupton proces jo të drejtë dhe procedurë të mangët, pasi ky raport duhet patjetër të votohet në Këshillin e Fakultetit sipas Rregullores për Zgjedhjen/Rizgjedhjen e Personelit Akademik në U. “K. Z.” ..., dhe pas miratimit apo refuzimit të propozimit nga komisioni, e dërgon në Komision të Studimeve si organ këshilldhënës i Senatit. Senati, edhe përkundër raportit pozitiv të Komisionit Recenzues për thirrjen akademike Profesor i Asociuar, ka rizgjedhur paditësin në thirrjen e njëjtë akademike, pra Profesor Asistent, pasi K. R. është vetëm komision që rekomandon, ndërsa vendimin përfundimtar në instancë të fundit e merr Senati i U. “K. Z.” ..., dhe ka praktika tjera nga Universitetet e ndryshme publike ku vendoset ndryshe nga raporti i propozuar. Prandaj, kundërshton në tërësi kërkesëpadinë dhe padinë e paditësit, pasi konsideron se paditësi nuk i ka plotësuar kushtet për të u avancuar dhe rrjedhimisht duhet të mbes në thirrjen akademike Profesor Asistent, prandaj kjo kërkesëpadi duhet të hidhet poshtë si e pabazuar.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor:

Në këtë drejtim gjykata për vlerësimin e drejtë të kësaj çështje juridike, ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: Konkursin me nr. ref... të dt.14.06.2019, për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të U. “K. Z.” ..., Gjiilan, për vitin akademik 2019/2020; Njoftimin me nr... , të dt.26.06.2019, për korrigjim të konkursit me nr. ref. ... të dt.14.06.2019, për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësinë akademike të Fakultetit Ekonomik në U. “K. Z.” ..., Gjiilan, për vitin akademik ...; Kërkesën me nr. ... të dt.28.06.2019, për avancim në pozitën Profesor i Asociuar; Kërkesën e dt. 28.06.2019, për aplikimin e Rregullores për Zgjedhjen e Personelit Akademik në U. “K. Z.” ..., në Gjiilan; Referatin e dt. 04.09.2019 të Komisionit Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik, të U. Publik “K. Z.” ... , Gjiilan; Vendimin me nr. ... të dt. 29.10.2019, të U. “K. Z.” Gjiilan; Ankesën me nr... të dt. 12.11.2019 të parashtruar nga paditësi G. T, për Senatin e U. “K. Z.” ..., Gjiilan; Kërkesën me nr. ... , të dt. 12.11.2019 të parashtruar nga paditësi G. T., për M. e A., Sh dhe T.; Vendimin me nr.... , të dt. 17.01.2020 të U. “K. Z.” Gjiilan; Vendimin me nr. ... , të dt.17.01.2020 të U. “K. Z. ... , Gjiilan; Vendimin me nr. ... të dt.31.01.2020 të U. “K. Z.” ..., Gjiilan; Mendimin juridik me nr. ... të dt. 24.12.2019 për Senatin e U. “K. Z.” ..., Gjiilan nga Komisioni Statutar i U. Publik “K. Z.” ... Gjiilan dhe Ekspertizën Financiare të punuar nga eksperti financiar-gjyqësor R. S., të datës 10.11.2020.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqës dhe provave të nxjerra, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, dhe ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar, dhe rrjedhimisht edhe e refuzoi, pasi që:

Me Konkursin me nr.ref... të dt.14.06.2019, për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësitë akademike të U. “K. Z” ... ,Gjilan, për vitin akademik 2019/2020, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura ka shpallur konkurs për mësimdhënës në Fakultetin Ekonomik, edhe atë, një mësimdhënës për lëndët: Hyrje në Mikroekonomi, Hyrje në Makroekonomi, Tregjet dhe Institucionet Financiare, Qeverisje korporative, Meaxhim i riskut dhe sigurimit; një mësimdhënës për lëndet: Hyrje në Mikroekonomi, Hyrje në Makroekonomi, Banka dhe afarizëm bankar, Financat korporative, analiza e investimeve, Menaxhmenti bankar; një mësimdhënës në lëndët: Financa, Financa ndërkombëtare, Menaxhimi i investimeve, Auditimi, Ekonomia e Kosovës dhe BE-së, Teoria dhe Politika monetare.

Me Njoftimin me nr. ... të dt.26.06.2019, gjykata ka vërtetuar faktin se e paditura e ka korrigjuar Konkursin me nr. ref. ... të dt.14.06.2019, për zgjedhjen/rizgjedhjen e personelit të rregullt akademik në njësinë akademike të Fakultetit Ekonomik në U. “K. Z.” ..., Gjilan, për vitin akademik 2019/2020, ashtu që në Fakultetin Ekonomik ka kërkuar tre mësimdhënës, në mesin e tyre dy mësimdhënës për grupin e lëndëve në Ekonomiksi dhe një mësimdhënës për grup lëndësh nga B., F... dhe Konatibilitet.

Me Kërkesën me nr.... të dt.28.06.2019 për avancim në pozitën Profesor i Asociuar, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi i është përgjigjur konkursit të shpallur me dt.14.06.2019 duke qenë i bindur se të arriturat e tij akademike dhe profesionale janë në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, dhe i plotëson kërkesat që dalin nga dispozitat e Statutit të Përkohshëm të U. “K. Z.” ..., duke konsideruar se plotësohen kushtet për avancimin e tij në pozitën “Profesor i Asociuar” të Fakultetit Ekonomik tek e paditura.

Me kërkesën e dt. 28.06.2019 për aplikimin e Rregullores për Zgjedhjen e Personelit Akademik në U. “K. Z.” ..., në Gjilan, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka kërkuar që të zbatohet rregullorja e lartëcekur e cila është në fuqi pasi është aprovuar nga Senati i UKZ-së, pasi që sipas kësaj rregullore, nenit 12 të saj, paditësi konsideron se i plotëson kushtet formale-juridike për avancim në pozitën Profesor i Asociuar, dhe si rrjedhojë i njëjti konsideron se në rastin konkret neni 18, paragrafi 2 i kësaj rregullore nuk duhet të aplikohet në rastin e paditësit.

Me Referatin e dt. 04.09.2019 të Komisionit Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik, të U. Publik “K. Z.” ...Gjilan, gjykata ka vërtetuar faktin se ky komision i ka paraqitur dy kandidat për grupin e lëndëve në Ekonomiksi, ku njëri nga kandidatët ka qenë edhe paditësi G. T..

Me Vendimin me nr. ... të dt. 29.10.2019, të U. “K. Z.” ..., Gjilan, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është zgjedhur/rizgjedhur profesor asistent për grup të lëndëve nga Ekonomiksi në Fakultetin Ekonomik të U. “K. Z.” ..., në Gjilan.

Me Ankesën me nr. ... të dt. 12.11.2019 të parashtruar nga paditësi G. T., për Senatin e U. “K. Z.” ..., Gjilan, gjykata ka vërtetuar faktin se Vendimin nr.... të Senatit të UKZ-së, të dt.29.10.2019, paditësi e ka konsideruar si të padrejtë, andaj ka kërkuar nga i njëjti organ që të rishqyrtojë kërkesën e tij për avancimin duke respektuar raportin e Komisionit recenzues dhe kornizën ligjore të aplikueshme në këtë rast.

Me Kërkesën me nr. të dt. 12.11.2019 të parashtruar nga paditësi G.T për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi më dt.12.11.2019 i është drejtuar M. së A., Sh dhe T.... (MASHT) me një kërkesë për konfirmimin e heshtjes administrative duke theksuar se paditësi më dt.28.06.2019 ka dorëzuar dosjen për avancim në

pozitën Profesor i Asociuar sipas konkursit të shpallur nga e paditura të dt.14.06.2019, e të cilës kërkesë i ka bashkëngjitur edhe kërkesën për mos zbatim të dispozitave kalimtare të nenit 18, paragrafi 2 të Rregullores për Zgjedhjen e Personelit Akademik në U. “K. Z.” ..., , në Gjilan me arsyet e cekura sikurse në këtë kërkesë, mirëpo, e paditura nuk ka kthyer përgjigje në këtë kërkesë, andaj paditësi ka kërkuar nga MASHT të ia konfirmojë heshtjen administrative dhe ta avancojë në pozitën Profesor i Asociuar.

Me Vendimin me nr. ... të dt. 17.01.2020 të U. “K. Z.” ..., Gjilan, gjykata ka vërtetuar faktin se Senati i Universitetit “Kadri Zeka” në Gjilan ka marrë vendim, e sipas të cilit vendim, me pikën I të këtij vendimi është miratuar interpretimi i komisionit statutar nga faqe 3 deri në faqe 6, ndërsa në pikën II të këtij vendimi është vendosur që intepretimi statutar të futet si pjesë përbërëse e Rregullores për Zgjedhjen e Stafit Akademik ... të dt.18.03.2019 në UKZ.

Me Vendimin me nr... të dt.17.01.2020 të U. “K. Z.” ..., Gjilan, gjykata ka vërtetuar faktin se Senati i U. “K. Z.” ..., ka formuar komisionin në përbërje prej 3 antarësh ku ka vendosur që t’i rishqyrtoj të gjitha dosjet e kandidatëve të cilët kishin konkuruar në konkursin ... të dt.14.06.2019.

Me Mendimin juridik me nr. ... të dt. 24.12.2019 për Senatin e U. “K. Z.” ...,” Gjilan nga Komisioni Statutar i U. Publik “K. Z.” Gjilan, gjykata ka vërtetuar faktin se ky komision ka dhënë mendimin juridik duke shprehur se kusht i domosdoshëm për avancim në UKZ është numri i publikimeve shkencore ndërkombëtare (varësisht nga thirrja) dhe jo lloji i tyre, gjithmonë sa i përket kushtit që ndërlidhet me zgjedhjen si Profesor i Rregullt, sipas nenit 155 par.1.2.1, Profesor i Asociuar neni 156, par.1.2 dhe Profesor Asistent neni 157, par.1.2.

Me Ekspertizën Financiare të punuar nga eksperti financiar-gjyqësor Ramadan Sejdiu, të datës 10.11.2020, gjykata ka vërtetuar faktin se eksperti ka përllogaritur diferencën mujore në neto, në shumat e cekura si në këtë ekspertizë, për periudhën kontestuese prej datës 01.10.2019 deri më datën 10.11.2020, duke llogaritur edhe shtesat neto, përkatësisht diferencat nga pagat mujore, obligimet ndaj TKPT në llogaritë e punëmarrësit dhe obligimet tatimore ndaj ATK-së, e më saktësisht si në këtë ekspertizë.

Baza ligjore:

Sipas nenit 8, parag. 2 të Ligjit nr.03/L-212 i Punës (në tekstin e mëtejshëm: LP) është paraparë se: “Konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi, ashtu siç parashihet me këtë ligj dhe aktet tjera në fuqi”. Me nenin 10, parag. 1 i LP, është paraparë se: “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji”. Përveç tjerash, edhe sipas nenit 3, par.1, nënpar 1.1 të LP-së, është përcaktuar se “Kontrata e punës është akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilat rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe me aktin e brendshëm të punëdhënësit”, ndërsa sipas nenit 17 parag.1 të po këtij ligji është përcaktuar se: “I punësuarit caktohet në vendin e punës, për të cilin ka lidhur kontratë pune”. Tutje, sipas nenit 78, parag. 2 të po këtij ligji (LP), është paraparë se: “Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të kërkesës”, ndërsa sipas nenit 79 të këtij ligji, parashihet se: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente”, ndërsa sipas nenit 80 të po këtij ligji, është paraparë se: “Nëse gjykata konstaton se ndërprerja e kontratës së punës nga ana e punëdhënësit është joligjore, në

bazë të dispozitave të këtij ligji, Kontratës Kolektive ose Kontratës së Punës, atëherë do të urdhërojë punëdhënësin që të ekzekutoj njërën prej këtyre dëmshpërblimeve: t'i paguajë të punësuarve kompensimin, përveç shtesave dhe shumave tjera të cilat i takojnë punonjësit në bazë të këtij ligji, Kontratës së Punës, Kontratës Kolektive ose Aktit të Brendshëm, në shumën të tillë që gjykata i konsideron të drejta dhe adekuate, por të cilat nuk duhet të jenë më pak se dyfishi i vlerës së çdo dëmshpërblimi që i takon punonjësit në kohën e shkarkimit, ose nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna. Punëdhënësi është i obliguar që në afatin e caktuar të zbatoj vendimin e gjykatës kompetente”.

Me nenin 2 parag.1, nënparag.1.1. të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraparë se: Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet”.

Sipas nenit 13 të Ligji për Arsimin e Lartë, është përcaktuar se: “Bartësit e licencuar të arsimit të lartë kanë autonominë dhe lirinë akademike”, ndërsa sipas Statutit të Përkohshëm të U. Publik të Gjilanit, “K. Z”,... me nenin 153, parag.1 të këtij Statuti është përcaktuar se “I gjithë personeli akademik gjatë perudhës së udhëhequr nga organet e përkohshme pas përfundimit të procedurave të rregullta do të emërohet nga Rektori dhe Këshilli i PTH në bashkëpunim me MASHT, sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e këshillit të njësisë akademike”, sipas parag.2 të po këtij statuti është përcaktuar se: “Nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim këshillit të njësisë akademike”, sipas parag. 3 të po këtij statuti është përcaktuar se: “Nëse këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit sjellë të njëjtin propozim, Senati në bashkëpunim me Rektoren dhe Këshillin merr vendim përfundimtar”. Po ashtu, me nenin 156, parag.1, pika 1.2 i këtij statuti është përcaktuar se: “Për titullin e profesorit të asocuar kandidati duhet t’i plotësojë këto kushte: Të ketë një numër të zgjedhur të monografive, publikimeve në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, me së paku 3 punime kryesore të publikuara në revista ndërkombëtare”.

Sipas Rregullores për Zgjedhjen e Personelit Akademik në Universitetin “K. Z” në Gjilan, Ref.nr... , të datës 18.03.2019, përkatesisht me nenin 8, parag.7 të kësaj rregullore, është paraparë se: “Komisioni recensues ia dorezon raportin njesise akademike, brenda 30 diteve, pas miratimit te vendimit per formimin e komisioneve vlerësuese”, ndërsa sipas parag.15 të po kësaj rregullore parashihet se: “Keshilli i Fakultetit e miraton apo e refuzon propozimin e komisionit dhe e dërgon ne Komision te Studimeve te Universitetit”, pastaj sipas parag.19 të rregullores është përcaktuar se: “Pesembdhjete (15) dite pas publikimit te vendimit te Senatit dhe njoftimit te kandidateve, mund te ushtrohet anekese (shkalla e dyte) ndaj vendimeve te Senatit”; dhe sipas parag. 20 të rregullores, është përcaktuar se: “Komisioni i ankesave i Universitetit do të shqyrtojë ankesat brenda tridhjete (30) diteve dhe i ben nje raport Senatit, ne te cilin miraton, refuzon apo hedh pretendimet e kandidateve”.

Me nenin 2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm:LPK), është paraparë se: “Në procedurë kontestimore gjykata vendos brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse”, ndërsa me nenin 7 të po këtij ligji, është paraparë se: ”Palët kanë për

detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Gjykata konstatoi se në këtë çështje kontestimore nuk ishte kontestues fakti se paditësi është i punësuar te e paditura, respektivisht në U. “K. Z.” ..., në Gjiilan që nga dt. 01.10.2014, dhe atë në pozitën e Profesorit Asistent në Fakultetin Ekonomik, ngase një gjë të tillë nuk e kanë mohuar e as kontestuar vetë palët ndërgjyqëse. Po ashtu, në këtë çështje nuk ishte kontestues as fakti se e paditura, në këtë rast U. “K. Z.” ..., kishte shpallur konkurs për tre kandidat në Fakultetin Ekonomik, fakt ky, i cili po ashtu vërtetohet nga Konkursi me numër Ref.nr...., i dt. 14.06.2019, e në të cilin konkurs ka aplikuar dhe ka qenë pjesëmarrës edhe paditësi për pozitën e pretenduar. Po ashtu, në mes të paleve nuk ishte kontestues fakti se paditësi nga Komisioni Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik ishte rekomanduar për thirrjen akademike Profesor i Asociuar.

Mirëpo, si fakt kontestues në mes të palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore ishte fakti nëse Rektori i U. “K. Z.” ..., në Gjiilan, kishte vepruar në kundërshtim me Referatin e Komisionit Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik, pasi që nuk përzgjedhur në pozitën Profesor i Asociuar, por në pozitën Profesor Asistent. Po ashtu kontestues ishte nëse Senati i U. “K. Z.” ..., a në Gjiilan me Vendimin me nr. ... , të dt. 29.10.2019, kishte vepruar në kundërshtim me vendimin e Komisionit Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik, pasi që nuk kishte bërë përzgjedhjen e paditësit për pozitën e lartëcekur.

Gjykata pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të administruara në këtë çështje kontestimore, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, për shkak se, paditësi përmes padisë ka kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën të lidhë kontratën e punës me paditësin në pozitën e Profesorit të Asociuar me përmbajtjen e cekur sikur në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e në rastin konkret gjykata vlerëson se nuk ka tagër që të vendos sipas kërkesës së paditësit dhe të detyrojë të paditurën që të lidhë kontratën e punës me paditësin, ngase, gjykata do të tejkalojë autorizimet e saj ligjore, e rrjedhimisht edhe do të cënonte parimet themelore të palëve ndërgjyqëse, autonominë e lirisë së palëve kontraktuese dhe barazinë e palëve. Gjykata, një vlerësim të tillë e bazon në dispozitën e nenit 10 parag.1 të LP, ngase, sipas kësaj dispozite në mënyrë decisive është përcaktuar se përveç kushteve tjera, respektivisht elementeve tjera të cilat duhet ti kete kontrata e punës sipas nenit 11 të këtij ligji, *e njëjta lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe punëmarrësi*. Po ashtu edhe me nenin 3 parag.1 nënparag.1.11 të këtij ligji është përkufizuar shprehja se çfarë kuptimi ka shprehja “Kontratë e Punës”, gjë që sipas kësaj dispozite është përcaktuar se shprehja Kontratë Pune ka këtë përkufizim: “Akt individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën Kolektive dhe me Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”, ndërsa sipas nenit 17 parag.1 të po këtij ligji është përcaktuar se: “I punësuarit caktohet në vendin e punës, për të cilin ka lidhur kontratë pune”. Në interpretim të dispozitave të lartëcekura, rezulton se palët kontraktuese, në këtë rast, palët ndërgjyqëse janë subjekte të cilat mund të lidhin, respektivisht nënshkruajnë një kontratë të tillë, mirëpo në asnjë rrethanë gjykata nuk mund të ndërhyjë dhe të detyroj palët që të lidhin kontratën e punës. Përveç tjerash, gjykata një konstatim dhe vlerësim të tillë e bazon edhe nga fakti se edhe me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (në tekstin e mëtejshëm: LMD), përkatësisht nenet 1,2 dhe 3 të këtij ligji janë përcaktuar parimet themelore për të gjitha marrëdhëniet e detyrimeve, e nga të cilat dispozita rezulton se te çdo marrëdhënie detyrimi pjesëmarrësit janë të lirë dhe të barabartë që të rregullojnë marrëdhëniet e detyrimeve në pajtim me dispozitat

urdhëruese të rendit publik dhe dokeve të mira, andaj nga këto arsye dhe arsyet e cekura lartë, gjykata vlerëson se në rastin konkret palët janë subjekte të vetme të cilat mund të lidhin kontratë pune, pasi që nga të njëjtit kontrata duhet nënshkruar, kusht ky i përcaktuar me nenin 10 par.1 i LP-së, prandaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të këtij dispozitivi duke u mbështetur në faktin se në këtë kontest paditësi ka kërkuar diferencën e të ardhurave personale të porealizuara nga data 01.10.2029 deri me 10.11.2020 duke kërkuar shumën prej 2194,17 €, duke i përfshirë të hyrat në emër të trustit personal dhe tatimit në pagë, e kjo diferencë sipas vlerësimit të gjykatës mund të paguhet vetëm atëherë kur punëtorit i është ndërprerë marrëdhënia e punës e kjo bazuar në nenin 80 par.1, pika 1.1 të Ligjit të Punës, kurse në rastin konkret paditësi nga thëniet e paraqitura në padi dhe nga administrimi i provave nuk është vërtetuar se i njëjti ka punuar në pozitën Profesor i Asociuar, apo se të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, pra paditësi edhe më tutje vazhdon të punoj tek e paditura në pozitën e Profesorit Asistent. Andaj, gjykata vlerëson se kjo kërkesë është e pa bazuar në ligj, për arsye se një drejtë e tillë nga marrëdhënia e punës nuk mund t'i njihet paditësit pa punuar dhe pa bazë ligjore.

Gjykata duke pasë parasysh faktin se paditësi përmes padisë dhe përgjatë tërë shqyrtimit gjyqësor nuk ka parashtruar ndonjë kërkesë tjetër në kuptim të anulimit të ndonjë akti si të paligjshme të të paditues, nuk është lëshuar në vlerësim e pretendimeve dhe në vërtetimin e fakteve të parashtruara nga paditësi lidhur me atë se a janë respektuar procedurat e rekrutimit nga shpallja e konkursit e deri te përzgjedhja e tij, kjo nga arsyeja se para kësaj gjykate nga paditësi nuk ka pasë ndonjë kërkesë të tillë, por si objekt shqyrtimi ka qenë vetëm kërkesa që të detyrohet i padituri t'i lidhë kontratë te punës paditësit, dhe të detyrohet i padituri që paditësit t'i kompensoj diferencën e të ardhurave personale, andaj gjykata në kuptim të nenit 2 të LPK-së nuk është lëshuar në vërtetimin e fakteve tjera ngase nuk kanë ndonjë ndikim për vendosjen më ndryshe.

Perveç tjerash, gjykata në kuptim të dispozitave të LP-së, dispozitave tjera të ligjeve dhe akteve nënligjore për zbatimin e tyre që rregullojnë fushën e caktuar, mund të siguroj mbrojtje gjyqësore për realizimin e të drejtave subjektive të palëve në rast të gjetjes së shkeljeve, apo mosrespektimin e procedurave ligjore të rekrutimit dhe të vlerësimit të akteve të palës së paditur në bazë të kërkesës së parashtruar, ku edhe mund t'i anulohet aktet të cilat nuk janë pajtim me dispozitat procedurale dhe materiale, dhe të udhëzoj palën e paditur që të rishqyrtoj edhe njëherë procedurën e rekrutimit nga fillimi, duke i evituar shkeljet e gjetura, mirëpo nuk mund të detyroj palët të lidhin kontratë pune nga arsyet e cekura me lartë.

Prandaj, gjykata duke marrë parasysh parimet themelore të procedurës kontestimore, përmes të cilave gjykata është e obliguar të vendosë vetëm brenda kufijve të kërkesave që janë parashtruar nga palët ndërgjyqëse, kjo ngase në procedurën kontestimore, pala duhet të ketë interes juridik për padinë dhe kufizon gjykatën të vendosë sipas kërkesëpadisë së paditësit. Përrjashtimisht, gjykata në kontestet familjare apo në raste të ngjashme mund të kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe të hetoj dhe shqyrtoj fakte dhe të siguroj prova edhe pa propozimin e tyre, dhe të vendos edhe në mungesë të parashtrimit të kërkesave, mirëpo në të gjitha situatat e tjera, gjykata vendosë vetëm në bazë dhe sipas kërkesës së parashtruar, duke mos u lëshuar në udhëzime materiale për plotësim apo korrigjim të kërkesëpadisë, pasi që nuk është në natyrën dhe frymën e raporteve civile-juridike të udhëzohet pala për dispozita materiale dhe duke u kujdesur që mos të tejkalohet kërkesëpadinë e paditësit.

I autorizuari i paditësit, përveç tjerash, për të vërtetuar pretendimet e paditësit dhe të drejtën subjektive të tij, si provë i ka bashkëngjitur fjalës përfundimtare edhe një Aktgjykim të

Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.497/19, nga i cili aktgjykim shihet se është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit V.R. nga Prishtina, e paraqitur kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “H. P”,... dhe është anuluar vendimi i senatit të këtij universiteti, duke e obliguar të paditurën që paditësin ta pranoj në pozitën mësimdhënës për lëndët Informatikë..., me decidivisht si në këtë aktgjykim, e po ashtu si referencë ka përmendur edhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, CA.nr.3719/2016 të dt.26.09.2016, sipas vlerësimit të kësaj gjykate një pretendim i tillë nuk qëndron dhe është i pabazuar, kjo nga arsyeja se, përveç faktit se objekti i kontestit dallon nga ky i parashtruar nga paditësi me padi, repektivisht dallon kërkesa e padisë, pasi që nga aktgjykimi i cekur më lartë është anuluar akti i të paditurës dhe është obliguar e paditura që paditësin ta pranoj në punë, ndërsa paditësi në rastin konkret ka kërkuar që të detyroj të paditurën të lidhë kontratë pune dhe t’i kompensojë diferencën e të ardhurave personale, gjykata konsideron se vendimet e gjykatave tjera nuk paraqesin bazë dhe arsye për vendosur sipas tyre, kjo nga arsyeja se sipas nenit 102 parag.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është përcaktuar qartë se *gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit*, ndërsa sipas nenit 4 të Ligjit për Gjykatat, është përcaktuar se gjykatat gjykojnë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Gjyqtarët gjatë ushtrimit të funksionit dhe marrjes së vendimeve janë të pavarur, të paanshëm, të pandikuar në çfarëdo mënyre nga asnjë person fizik apo juridik, përfshirë edhe organet publike. Kufizimi i gjykatave që të mund të kenë pushtet jashtë kufijve të vendosur nga Kushtetuta dhe ligjet është standard i mbrojtjes nga arbitrariteti i pushtetit gjyqësor, në njërën anë, dhe në anën tjetër, standard themelor i demokracisë i shprehur si kushtetutshmëria dhe ligjshmëria. Nga sa u tha, gjykata kontestet e parashtruara para saj i zgjidhë ashtu siç është rregulluar me normat juridike, qoftë ato procedurale edhe ato të natyrës materialo-juridike nga i cili ka lindur kontesti, dhe natyrisht se gjykata është e lirë për vlerësuar dhe vendosur se cilat fakte do t’i konsideroj të provuara e cilat jo, pastaj çmuarjen e provave veç e veç e të gjithave së bashku, e në këtë mënyrë të arrijë në përfundimin e duhur ligjor. Andaj, gjykata konsideron se nuk është e lidhur e as e ndikuar nga vendimet tjera të gjykatave tjera për të vendosur, por që, gjykata vendimin e saj e bazon në bazë të shqyrtimit të gjithëmbarshtëm dhe provave të administruara dhe në pajtim me normat juridike.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimin e të paditurës ku ka theksuar se padia e paditësit është paraqitur para afatit ligjor, duke konsideruar se paditësi ka ngritur padi ende pa përfunduar procedurat e parapara me aktet normative të universitetit, mirëpo, gjykata ka konstatuar se ky pretendim nuk qëndron për arsye se Senati i U. “K. Z.” ..., ne Gjilan, me dt.14.10.2019, ka marrë vendim për zgjedhjen e paditësit si Profesor Asistent për grupin e lëndëve Ekonomiksi, ndërsa me dt.12.11.2019, i njëjti ka paraqitur ankesën lidhur me vendimin e lartëcekur nga Senati i U. “K. Z.” ..., dhe procedura ka vazhduar në procedurë administrative, ndërsa me dt.24.12.2019 ka paraqitur padi në këtë gjykatë, çka do të thotë se të njëjtën paditësi e ka paraqitur në afatin e paraparë ligjor, e rrjedhimisht padia e paditësit është e lejuar për t’u shqyrtuar, pra nuk ka pengesa të natyrës procedurale për lejueshmërinë e procesit si prezumim procedural. Andaj, gjykata vlerëson se padia e paditësit është parashtruar në afatin e përcaktuar sipas nenit 78 dhe 79 të LP-së, dhe pas plotësimit të kushteve ligjore për iniciimin e kontestit të punës referuar dispozitave të lartëcekura.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve, si dhe ka administruar dhe vlerësuar edhe provat tjera, mirëpo, vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim vendimtar në zgjidhjen e kësaj çështje juridike.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në bazë të neneve 450, 452 dhe 463 të LPK-së, pasi që paditësi ka humbur procesin gjyqësor, ndërsa pala e paditur nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Ngase u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE GJILAN
C.nr.1174/19, me datë 15.01.2021

Gjyqtari,
Blerim BESHTICA

UDHËZIM JURIDIK:Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.